



MODELI I POLITIKËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

QERSHOR 2018

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, i themeluar në vitin 2011, është një koalicion i përbërë nga 27 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët avokimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Ky dokument publikohet në kuadër të Grupit Tematik për Arsim dhe Grupit Tematik për Mirëqenie dhe Mbrojtje të Fëmijëve në KOMF, mbështetur nga zyra e UNICEF në Kosovë.

Organizatat anëtare të KOMF janë:

Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë – KESD, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – ORA, One To One Kosova, Qendra e Këshillimit për Familje – QKF, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE dhe World Vision.

Ky publikim nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimet e donatorëve të KOMF.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	4
1. PARIMET DHE VLERAT KRYESORE TË ORGANIZATËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËS	5
1.1 Përkufizimet.....	6
1.2 Çka është abuzimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve?	6
2. NEVOJA PËR POLITIKËN E MBROJTJES SË FËMIJËS.....	8
PARANDALIMI	9
3. APLIKIMI I POLITIKËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËS	9
3.1 Vetëdijësimi	9
3.2 Vlerësimi i rrezikut dhe dizajnimi i programit të sigurt	9
3.3 Procesi i rekrutimit të sigurtë.....	9
3.4 Trajnimi dhe edukimi	10
3.5 Protokollet e sjelljes	10
3.6 Personi pikë kontakti përgjegjës i mbrojtjes së fëmijës.....	10
4. Kodi i Sjelljes së Organizatës për Mbrojtjen e Fëmijës	12
REAGIMI DHE MBROJTJA	14
5. Procedurat e raportimit.....	14
5.1 Procedura e brendshme e mbrojtjes	15
MEDIA DHE KOMUNIKIMI	16
6. Udhëzime për Media dhe komunikimin	16
6.1 Parimet	16
6.2 Pëlqimi paraprak	17
6.3 Intervistimi i fëmijëve.....	17
6.4 Vizitat nga fotografët, produksionet filmike, gazetarët dhe të tjerët.....	18
MONITORIMI DHE LLOGARIDHËNIA	19
7. Llogaridhënia: Monitorimi dhe Vlerësimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës.....	19
8.DEKLARATA E ZOTIMIT E ORGANIZATËS PËR POLITIKËN E MBROJTJES SË FËMIJËS	20
9. REFERENCA RRETH KARAKTERIT	21
SHTOJCAT	22
Shtojca 1: Njohja e shenjave të abuzimit	22
Shtojca 2: Forma raportuese e mbrojtjes	24
Shtojca 3 Format e pëlqimit.....	28

HYRJE

Abuzimi i fëmijëve është një fenomen global. Ai ndodh në të gjitha vendet dhe në të gjitha shoqëritë. Abuzimi përfshin abuzimin fizik, seksual, emocional dhe neglizhimin e fëmijëve. Abuzimi tek fëmijët mund të parandalohet. Fëmijët mund të jenë potencialisht të ekspozuar ndaj shfrytëzimit, abuzimit, dhunës dhe neglizhimit në familje, komunitet, institucione, organizata, vende private dhe vende publike nga rrethana të ndryshme dhe nga njerëz të ndryshëm, përfshirë personelin apo profesionistët e mandatuar për mbrojtje dhe përkujdesje të fëmijëve. Ky model i Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës, është zhvilluar për të adresuar mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi i mundshëm.

Ky model i Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës është bërë bazuar në politikën e mbrojtjes së fëmijës të EuroChild. Eurochild është një rrjet organizatash dhe individësh me bazë në Bruksel, që punojnë në të gjithë Evropën për të promovuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve. Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF është anëtare në rrjetin Eurochild.

KOMF me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve, krijimit të një ambienti të sigurtë dhe miqësor, për të siguruar standardet më të larta të sjelljes dhe praktikës profesionale, për të siguruar që asnjë dëm nuk do t'ju ndodhë në asnjë situatë fëmijëve gjatë përfshirjes

së tyre në programet e organizatave që punojnë me fëmijët, prezanton modelin e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës, si një mjet që rrit vetëdijen dhe të kuptuarit e përbashkët mbi abuzimin, si dhe krijon një sistem parandalimi, reagimi dhe mbrojtjeje për fëmijët ndaj formave të ndryshme të abuzimit.

Ky model përmban parimet dhe kornizat kryesore të nevojshme të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës, si dhe mbështetet nga udhëzime të qarta mbi atë se si duhet të zbatohet nga organizatat që punojnë me fëmijët. Procedurat e veçanta dhe listat kontrolluese janë pjesë e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës, duke përfshirë procedurat e raportimit për veprimet të cilat nuk janë në përputhje me standardet e mbrojtjes së fëmijëve.

KOMF inkurajon të gjitha organizatat jo qeveritare dhe qeveritare, organizatat fitim prurëse, të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, të hartojnë dhe të adaptojnë Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës, bazuar në programet dhe specifikat e organizatës, për të garantuar një ambient të sigurtë dhe mbrojtës për fëmijët. Krahas hartimit të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës, organizatat rekomandohen fuqishëm të bëjnë ngritjen e kapaciteteve të personelit për zbatimin e politikës.

1. PARIMET DHE VLERAT KRYESORE TË ORGANIZATËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

■ Bazuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe legjislacionin vendor

Kjo Politikë e Mbrojtjes së Fëmijës i dedikohet mbrojtjes së fëmijëve siç përcaktohet nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Të gjithë fëmijët e përfshirë në programet e organizatave kanë të drejtën të kenë shëndetin, sigurinë, mirëqenien si dhe interesin e tyre më i mirë të jetë konsiderata kryesore; Të promovohet zhvillimi i tyre në mënyrë që ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë; Të vlerësohen, respektohen dhe kuptohen brenda kontekstit të kulturës, religjionit dhe përkatësisë etnike të tyre; Të dëgjohen dhe pikëpamjet e tyre të konsiderohen me kujdes si dhe të inkurajohen dhe të ndihmohen për të marrë pjesë në vendimet që i prekin ata, përfshirë vendimet për mbrojtjen e fëmijëve.

Ne punojmë bazuar në instrumentet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendor për mbrojtjen e fëmijëve.

■ Mbrojtja e fëmijëve është përgjegjësi e pa negociueshme

Organizatave që punojnë për të drejtat e fëmijëve kanë përdorur detyrë absolute të mbrojnë fëmijët nga abuzimi, keqtrajtimi, dhe shfrytëzimi brenda organizatave. Kjo detyrë është e domosdoshme dhe e panegociueshme. Pa standarde dhe mekanizma adekuat për mbrojtjen e fëmijëve, një organizatë jo vetëm që dështon në detyrën e saj primare të kujdesit, por gjithashtu mund të neglizhojë ose të nxisë një mjedis abuzimi.

Të gjitha raportimet shqetësuese në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e një fëmije do të merren seriozisht. Kur është e nevojshme, do të ndërmerren hapa të përshtatshëm për të mbrojtur fëmijën dhe për të ndërmarrë veprimet kundër kryerësit të supozuar. Kjo mund të përfshijë referimin e rastit tek shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve si dhe raportimin drejt organeve të rendit dhe drejtësisë. Në lidhje me

akuzat ndaj personelit, vullnetarëve dhe partnerëve, veprimet mund të përfshijnë gjithashtu pezullimin ose ndërprerjen çdo lloj bashkëpunimi apo angazhimi.

■ Promovimi i ambientit të hapur

Organizatave pa procedura të duhura dhe të qarta, janë jashtëzakonisht të ndjeshme abuzimit të fëmijëve. Për më tepër, organizatave me struktura të dobëta të komunikimit rrezikojnë të infiltrohen nga persona, siç janë pedofilët, të cilët përpiqen të abuzojnë me fëmijët. Prandaj, organizatave duhet të synojë:

- Krijimin e një mjedisi ku çështjet e mbrojtjes së fëmijës diskutohen hapur dhe kuptohen midis fëmijëve dhe të rriturve;
- Promovimin e linjave të hapura të komunikimit brenda dhe jashtë organizatës, brenda dhe ndërmjet organizatave, për të përmirësuar ndërgjegjësimin dhe zbatimin e politikave dhe praktikave të mbrojtjes së fëmijës;
- Krijimin e një sistemi për të trajtuar në mënyrë të hapur, të qëndrueshme dhe të drejtë pohimet në lidhje me abuzimin direkt dhe indirekt.

■ Pjesëmarrja e fëmijëve

Organizatave punojnë me dhe për fëmijët duke u përpjekur për një shoqëri që respekton të drejtat e fëmijëve. Organizatave duhet të promovojë krijimin e hapësirave ku fëmijët ndihen të aftë dhe të gatshëm të flasin për abuzimin, dhe i fuqizon ata që të bëhen aktorë në mbrojtjen e tyre pa diskriminim. Organizatave duhet të promovojë fuqizimin e fëmijëve duke i bërë ata të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe krijimin e një mjedisi të sigurt në të cilin ata mund të ushtrojnë të drejtat e tyre.

Organizatave duhet të synojë të promovojë dhe sigurojë pjesëmarrjen e fëmijëve bazuar në kërkesat, si më poshtë:

- Pjesëmarrja është transparente dhe informuese
- Pjesëmarrja është vullnetare
- Pjesëmarrja është e respektueshme
- Pjesëmarrja është relevante
- Pjesëmarrja është miqësore për fëmijët
- Pjesëmarrja është gjithëpërfshirëse
- Pjesëmarrja mbështetet nga trajnimi
- Pjesëmarrja është e sigurt

1.1 Përkufizimet

■ Fëmijë

Fëmijë përkufizohet secili person nën moshën 18 vjeç, në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (1989).

■ Mbrojtja e fëmijës

Në kontekst të këtij dokumenti, mbrojtja e fëmijëve nënkupton detyrën e organizatës për të siguruar që personeli dhe programet të mos dëmtojnë fëmijët, të mos i ekspozojnë fëmijët drejt rrezikut dhe abuzimit dhe se çdo shqetësim që ka organizata lidhur me sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve do të raportohen tek autoritetet përkatëse.

■ Kontakti i drejtpërdrejtë me fëmijët

Kontakti i drejtpërdrejtë me fëmijët nënkupton të qenurit në prezencë fizike të fëmijës/fëmijëve në kontekstin e punës së organizatës, pavarësisht nëse kontakti është i rastit ose i rregullt, i shkurtër apo afatgjatë. Kjo mund të përfshijë pjesëmarrjen në takime dhe konferenca në të cilat fëmijët janë të pranishëm ose puna direkte me fëmijë në ambientet e organizatës.

■ Kontakti jo i drejtpërdrejtë me fëmijët

Kontakti jo i drejtpërdrejtë me fëmijët nënkupton të pasurit qasje në informatat e fëmijëve në kontekstin

e punës së organizatës, siç janë emrat e fëmijëve, adresat, fotografitë dhe anamnezat sociale të tyre.

1.2 Çka është abuzimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve?

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, “abuzimi i fëmijëve” ose “keqtrajtimi” përbën “të gjitha format e abuzimit fizik, abuzimit psikologjik, abuzimit seksual, neglizhimit, duke rezultuar në dëm aktual ose potencial të shëndetit të fëmijës, mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënieje të përgjegjësive, besimit ose fuqisë”¹.

Të kuptuarit tonë për abuzimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

■ **Abuzimi fizik**² mund të përfshijë goditjen, shkundjen, hedhjen, djegien, fundosjen, mbytjen ose shkaktimin e dëmtimeve fizike tek një fëmijë. Dëmi fizik mund të shkaktohet edhe kur një prind ose kujdestar i shkakton qëllimisht sëmundje një fëmije për të cilin ata po kujdesen.

■ **Abuzimi psikologjik**³ definohet si keqtrajtim psikologjik i vazhdueshëm i fëmijës që shkakton efekte të rënda dhe të vazhdueshme në zhvillimin psikologjik dhe emocional të fëmijës. Kjo mund të përfshijë ndikimin tek fëmijët se ata janë të pavlefshëm dhe të padashur, të pamjaftueshëm ose të vlerësuar vetëm për atë sa plotësojnë nevojat e një personi tjetër. Abuzimi psikologjik mund të përfshijë veprimet që fëmijët të ndjehen të frikësuar ose në rrezik, ose të shfrytëzohen. Disa nivele abuzimi emocional mund të përfshihen në të gjitha llojet e keqtrajtimit të një fëmije, megjithëse mund të ndodhë edhe i vetëm.

■ **Abuzimi seksual**⁴ përfshin nxitjen ose joshjen e një fëmije për të marrë pjesë në aktivitete seksuale, pavarësisht nëse fëmija është në dijeni të asaj që

¹ Përkufizimi i OBSH për Abuzimin e Fëmijëve siç përcaktohet në Raportin e Konsultimit për Parandalimin e Abuzimit të Fëmijëve OBSH – 1999

²Burimi: Fletë informacioni për mbrojtjen e fëmijëve: Përkufizimet dhe shenjat e abuzimit të fëmijëve. NSPÇ, 2009

³Burimi: Fletë informacioni për mbrojtjen e fëmijëve: Përkufizimet dhe shenjat e abuzimit të fëmijëve. NSPÇ, 2009

⁴Burimi: Fletë informacioni për mbrojtjen e fëmijëve: Përkufizimet dhe shenjat e abuzimit të fëmijëve. NSPÇ, 2009

po ndodh. Aktivitetet mund të përfshijnë kontaktin fizik, përfshirë akte penetruese (për shembull, përdhunimin) ose akte jo-penetruese. Abuzimi seksual mund të përfshijë aktivitete pa kontakt fizik, të tilla si përfshirja e fëmijëve në shikimin ose në prodhimin e materialeve pornografike ose shikimin e aktiviteteve seksuale ose inkurajimin e fëmijëve që të sillen në mënyra seksuale të papërshtatshme.

- **Neglizimi**⁵ përcaktohet si dështim i vazhdueshëm për të përmbushur nevojat themelore fizike dhe/ose psikologjike të fëmijës, që mund të rezultojë në dëmtim serioz të zhvillimit fizik ose njohës të fëmijës.

Një fëmijë që abuzohet mund të përjetojë më shumë se një lloj të abuzimit. Diskriminimi, ngacmimi dhe bullizmi/ngacmimi gjithashtu janë veprime abuzive dhe mund të dëmtojnë një fëmijë, fizikisht dhe emocionalisht.

⁵Burimi: Fletë informacioni për mbrojtjen e fëmijëve: Përkufizimet dhe shenjat e abuzimit të fëmijëve. NSPÇ, 2009

2. NEVOJA PËR POLITIKËN E MBROJTJES SË FËMIJËS

Të gjitha organizatat dhe profesionistët që punojnë ose janë në kontakt me fëmijët janë të obliguar të sigurojnë që veprimet e tyre janë “të sigurta për fëmijët” prandaj duhet të kenë një Politikë për Mbrojtjen e Fëmijës⁶

Organizata ka nevojë për një Politikë për Mbrojtjen e Fëmijës sepse:

- **Fëmijët janë të mbrojtur:** Të gjithë fëmijët kanë të drejtën për mbrojtje nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit, bazuar në KDF. Prandaj është përgjegjësi e organizatës për të siguruar që të gjitha aktivitetet, politikat, programet e saj janë “të sigurta për fëmijët”. Kjo do të thotë që stafi nuk paraqet rrezik për fëmijët dhe se programet, politikat dhe praktikat mund të hartohen dhe zhvillohen në mënyra që promovojnë mbrojtjen e fëmijëve. Disa fëmijë janë veçanërisht të cenueshëm ndaj abuzimit, shfrytëzimit dhe keqtrajtimit nga

kujdestarët, punonjësit e organizatave dhe atyre që kanë qasje në informacionet e tyre personale. Shumë fëmijë që janë rritur në rrethana të cenueshme tashmë kanë përjetuar marrëdhënie të thyera të besimit ose abuzim në një raport (të rritur-fëmijë) në formën e abuzimit fizik, psikologjik, seksual ose neglizhimit.

- **Stafi i organizatës dhe reputacioni i saj janë të mbrojtura:** Organizatat pa politika, udhëzime dhe sisteme të mbrojtjes janë më të rezikuara ndaj akuzave të rreme ose keqdashëse të abuzimit. Pa një politikë të përshtatshme dhe pa standardet për mbrojtjen e fëmijës, pohimet për abuzim, qofshin të bazuara ose të pabazuara, mund të dëmtojnë reputacionin e një organizate. Kjo do të ketë implikime serioze, përfshirë dëmtimin e reputacionit të sektorit për të drejtat e fëmijëve në përgjithësi.

⁶Burimi: Mbajtja e fëmijëve të sigurt: ‘Standardet e mbrojtjes së fëmijëve dhe si t’i zbatojmë ato’.

PARANDALIMI

3. APLIKIMI I POLITIKËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës vlen për:

- Të gjithë personelin, menaxhmentin, anëtarët e bordit, praktikantët dhe vullnetarët;
- Të gjithë ata që veprojnë në emër të organizatës, sikurse anëtarët, këshilltarët ose trajnerët;
- Të gjithë ata të rritur që shoqërojnë fëmijët në ngjarjet dhe aktivitetet të organizuara nga organizata;
- Të gjithë ata që marrin pjesë në ngjarjet e organizatës duke përfshirë fëmijët, gazetarët, sponsorët, donatorët, politikbërësit, partnerët etj.

Të gjithë individët e përmendur më lart do të lexojnë Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës të organizatës dhe do të nënshkruajnë deklaratën e angazhimit për t'ju përmbajtur parimeve dhe procedurave të saj (shih faqe 21).

Një version miqësor i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës rekomandohet të zhvillohet në bashkëpunim me fëmijët.

3.1 Vetëdijësimi

Për zbatimin efektiv të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës, ajo duhet të kuptohet me saktësi nga të gjithë ata që e zbatojnë politikën. Organizata duhet të sigurojë se i gjithë personeli i saj, përfshirë praktikantët, vullnetarët, konsulentët etj, informohen për këtë politikë dhe veprojnë në përputhje me të gjitha dispozitat e saj.

3.2 Vlerësimi i rrezikut dhe dizajnimi i programit të sigurt

Organizata duhet të angazhohet në hartimin e programeve që janë të sigurta për fëmijët. Prandaj, vlerësimi i rrezikut duhet të bëhet gjatë hartimit të programeve dhe aktiviteteve si dhe të zhvillohen strategji të sigurisë në përputhje me rrethanat.

Gjithashtu, duhet të zhvillohen strategjitë për zbutjen e rreziqeve, për të minimizuar rreziqet ndaj fëmijëve.

3.3 Procesi i rekrutimit të sigurtë

Qëllimi i rekrutimit të sigurt është të vendos një sërë veprimesh që synojnë të ulin shanset e punësimit të personit 'të gabuar'.

Si kusht për të punuar me organizatën, i gjithë personeli, menaxhmenti, anëtarët e bordit, praktikantët, vullnetarët dhe të gjithë ata që veprojnë në emër të organizatës, si anëtarët, konsulentët ose trajnerët, duhet t'i nënshtrohen:

1. Pranimit dhe përkushtimit ndaj Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodit të Sjelljes për të punuar me fëmijët, duke nënshkruar deklaratën e angazhimit (shih shtojcën) për t'ju përmbajtur parimeve dhe procedurave të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës.

Prandaj në procesin e rekrutimit:

- Përfshini një deklaratë të qartë në lidhje me angazhimin e organizatës për të mbrojtur fëmijët, në shpalljen për vendin e punës.
- Stafit, vullnetarët, praktikantët dhe konsulentët duhet të rekrutohen me përkushtimet e punës të qarta, duke përfshirë përgjegjësinë për zbatimin e politikës së organizatës për mbrojtjen e fëmijës.
- Të gjitha intervistat e rekrutimit duhet të përfshijnë një diskutim mbi mbrojtjen e fëmijës, mirëkuptimin e kandidatit për angazhimin në mbrojtjen e fëmijës.
- Pajtimi për pranimin dhe respektimin e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës dhe Kodit të Sjelljes duhet të jetë pjesë e kontratave të punësimit dhe marrëveshjeve për shërbimet e fëmijëve.

2. Verifikoni identitetin e kandidatit, sepse shkelësit mund të japin informacion të rreme - duke përfshirë identitet të rremë - për të siguruar një punë.

3. Nënshkrimi i një deklaratë personale ku tregohet çdo dënim penal.

4. Vërtetimi që personi nuk është nën hetime - duhet të kërkohej nga policia apo Këshilli Gjyqësor.

5. Emrat dhe kontaktet e dy referencave të personave që kanë njohur për jo më pak se dy vjet duhet të kërkohej, duke përjashtuar personat me të cilët kanë lidhje familjare. Identiteti i referencave duhet të verifikohet.

3.4 Trajnimi dhe edukimi

Edukimi dhe trajnimi janë thelbësor për zbatimin e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës.

Kjo përfshin:

- Në fillimin e periudhës së hyrjes në punë (brenda 3 javëve nga marrja e pozitës) të personelit, vullnetarëve/praktikantëve/anëtarëve, ata duhet të marrin një trajnim për Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës nga personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës.
- Trajnimi për mbrojtjen e fëmijës duhet ti jepet të gjithë personelit pa përjashtim, vullnetarëve dhe praktikantëve.
- Trajnimet e mbajtura duhet të mbahen në dosjet e organizatës.

3.5 Protokollet e sjelljes

Çdo staf, punonjës, vullnetar, praktikant, anëtar i bordit, konsulent ose këshilltar do të informohet plotësisht për Kodin e Mirësjelljes së Organizatës (bashkangjitur).

3.6 Personi pikë kontakti përgjegjës i mbrojtjes së fëmijës

Organizata duhet të caktojë/emërojë një person përgjegjës brenda organizatës si pikë kontakti përgjegjës i mbrojtjes së fëmijës, i cili do të jetë përgjegjës:

- Të veprojë si pikë e parë e kontaktit për shqetësimet në lidhje me incidentet e mbrojtjes së fëmijëve dhe për ti ngritur ato shqetësime tek menaxhmenti/bordi.
- Promovimin dhe vetëdijësimin për zbatimin e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës në të gjithë organizatën.
- Promovimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës karshi fëmijëve, familjeve dhe komunitetit.
- Monitorimin e zbatimit të politikës dhe raportimin mbi implementimin e politikës në mbledhjet e ekipit, menaxhmentit apo bordit (varësisht nga struktura organizative).
- Identifikimin, mundësimin e trajnimeve për mbrojtjen e fëmijës.
- Mbajtjen e raporteve të sakta për çdo incident.
- Ndarjen e praktikave më të mira dhe ndarjen e obligimeve dhe kërkesave ligjore.
- Vepron si një burim mbështetës për stafin për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.

Emri dhe kontaktet e personit përgjegjës të mbrojtjes së fëmijës duhet të shfaqen qartë në zyrën e organizatës dhe stafi i ri duhet të njoftohet për rolin e tij/saj.

Shpалosja e informacionit personal mbi fëmijët, duke përfshirë rastet, duhet të kufizohet tek ata punonjës, që kanë nevojë të dinë për rastin. Organi më i lartë drejtues apo mbikqyrës në organizatë do të ketë përgjegjësinë e përgjithshme për të mbikëqyrur dhe për të siguruar zbatimin e politikës.

Procedurat specifike dhe listat kontrolluese janë pjesë e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës dhe përmenden në kapitujt 6 dhe 7, të cilat kanë të bëjnë me strategjinë e zbatimit të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës, duke

përfshirë procedurat e raportimit dhe proceset e monitorimit dhe vlerësimit. Mbrojtja do të përfshihet në zhvillimin e programeve nga organizata.

Aftësitë dhe karakteristikat e sugjeruara për personin pikë kontakti përgjegjës i mbrojtjes së fëmijës:

- Të ketë njohuri dhe përvojë rreth mbrojtjes së fëmijëve.
- Të ketë respekt dhe autoritet brenda organizatës në mënyrë që të vlerësohet mendimi i tij/saj.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi me të rriturit dhe fëmijët.
- Të jetë në gjendje të mbajë qetësinë kur të ngrihet një shqetësim, veçanërisht nëse një fëmijë ka nevojë për mbrojtje.
- Të jetë në gjendje të punojë me të tjerët për të siguruar zbatimin e politikës dhe për të reaguar aty ku ka ndodhur incidenti.
- Të ketë angazhimin për ruajtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre - së bashku me aftësinë për të avokuar.
- Të ketë shkathtësitë për trajnime dhe prezantime.
- Të jetë në gjendje të mbajë informacionin konfidencial.

4. KODI I SJELLJES SË INSTITUCIONIT/ORGANIZATËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

Organizata është e angazhuar për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi. Ajo do të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të parandaluar dhe/ose t'u përgjigjet fëmijëve në situata të tilla. Organizata do t'i përgjigjet të gjitha raporteve të abuzimeve të vërteta ose të supozuara bazuar në Politikën e saj të Mbrojtjes së Fëmijës, pavarësisht nga natyra e referimit, akuzat ose referuesi.

Ky Kod i Sjelljes përfshin udhëzime mbi standardet etike të sjelljes si dhe sjelljes së përshtatshme të të rriturve ndaj fëmijëve, si dhe të fëmijëve ndaj fëmijëve të tjerë. Ajo është zhvilluar bazuar në interesin më të mirë të fëmijës si konsideratë primare.

RAPORTONI çdo vëzhgim të dyshimtë ose abuzim të supozuar, çdo shkelje të Kodit të Sjelljes ose të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës, si dhe çdo rrethanë ose situatë, të cilat mund të jenë subjekt i keqinterpretimeve tek Personi Përgjegjës i Mbrojtjes së Fëmijës.

Seksionet 6.1 dhe 6.2 përshkruajnë pasojat për shkeljen e kodit të sjelljes ose të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës.

Personeli gjithmonë duhet:

- Të jetë i vetëdijshëm se çfarë e përbën abuzimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve (të përfshirë në Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës) dhe të kuptojë dispozitat e saj.
- Të njohë shenjat e abuzimit dhe të raportojë dyshimet menjëherë te personi i përcaktuar si pikë kontakti përgjegjës i mbrojtjes së fëmijës.
- Të sigurohet që e di se kush është personi i përcaktuar si pikë kontakti përgjegjës i mbrojtjes së fëmijës në organizatë.
- Të respektojë linjat e autoritetit dhe procedurat e raportimit.
- Të trajtojë të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë: të jetë gjithëpërfshirës dhe të përfshijë të gjithë fëmijët pa diskriminim.
- Të jetë i kujdesshëm për mënyrën se si gjuha, veprimet dhe marrëdhëniet me fëmijët mund të perceptohen.
- Të sigurojë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin personal, fizik, social, emocional, moral dhe intelektual të fëmijëve.
- Të inkurajojë dhe respektojë zërin dhe pikëpamjet e fëmijëve.
- Fuqizimi i fëmijëve në mënyrë që të mbrojnë veten sa më mirë.
- Të jetë i vetëdijshëm për situatat me rrezik mes bashkëmoshatarëve (p.sh. përzierja jo e mbikëqyrur e fëmijëve më të vjetër dhe më të rinj dhe mundësitë e diskriminimit ndaj fëmijëve më të vegjël në moshë).
- Të jetë i vetëdijshëm për mundësinë e abuzimit mes bashkëmoshatarëve (p.sh. ngacmimi mes fëmijëve).
- Të zhvillojë masa të veçanta të mbikëqyrjes, për mbrojtjen e fëmijëve të rinj dhe veçanërisht mbrojtjen e fëmijëve të cenushëm nga abuzimi nga bashkëmoshatarët dhe të rriturit.
- Të respektojë të drejtat themelore të të tjerëve duke u përballur me ndershmëri, sinqeritet dhe duke i trajtuar njerëzit me dinjitet dhe respekt.
- Të punojë në mënyrë aktive për të siguruar nivelet më të larta të respektit ndaj njëri-tjetrit.
- Të ruajë standardet e larta të sjelljes personale dhe profesionale edhe me të tjerët.
- Të mbrojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve, vetes dhe të tjerëve.
- Të kufizojë qasjen dhe/ose mostë ekspozojë fëmijët në ndonjë material elektronik të papërshtatshëm.
- Gjithmonë të respektojë konfidencialitetin e të dhënave personale të fëmijëve.
- Të marrë pëlqimin me shkrim nga fëmija dhe prindi/kujdestari kur fotografon, filmon ose kërkon informacion personal për aktivitete (shih seksionin 7).
- Të sigurojë që të ketë një minimum prej dy anëtarësh të stafit të pranishëm në takimet me fëmijët (për të lejuar që dikush të dalë për t'u

marrë me nevojat e menjëhershme të fëmijëve).

- Të sigurojë që kur fëmijët me aftësi të kufizuara marrin pjesë, të gjitha ndërtesat të jenë plotësisht të qasshme për ta.
- Të ofrojë informacionin e saktë për pajisjet specifike të përdorura nga fëmijët me aftësi të kufizuara përpara ngjarjeve për të siguruar qasjen në të gjitha ndërtesat, takimet, hapësirat.
- Të sigurojë që të rriturit shoqërues të fëmijëve nuk duhet të jenë më të rinj se 21 vjeç.
- Kur pjesëmarrësit janë të ftuar të qëndrojnë gjatë natës, marrëveshjet për ndarjen në dhoma duhen dakorduar më parë dhe me pëlqimin e prindërve/ kujdestarëve dhe fëmijëve.

ÇFARË NUK DUHET TË BËNI:

- Mos u angazhoni në asnjë formë të aktivitetit seksual me fëmijët.
- Shmangni çdo veprim apo sjellje që mund të interpretohet si praktikë apo sjellje e dobët ose potencialisht abuzive. Për shembull, të mos silleni kurrë në mënyrë të papërshtatshme ose seksualisht provokative.
- Asnjëherë mos lejoni një fëmijë të qëndrojë gjatë natës në dhomën e të rriturve ose të fle në të njëjtën dhomë me të rritur.
- Mos bëni aktivitete për fëmijët, të cilat mund t'i bëjnë vetë, duke përfshirë veshjen, larjen dhe përgatitjen.
- Mos diskriminoni, turpëroni, poshtëroni, ose degradoni fëmijën. Kjo përfshin çdo gjë që mund të konsiderohet abuzim emocional (p.sh. përdorimi i gjuhës së papërshtatshme që do të ndikojë emocionalisht tek fëmija ose të tregohet një tregim/ngjarje që do të ndikojë emocionalisht tek fëmija).
- Mos i goditni ose sulmoni fizikisht fëmijët.
- Mos u sillni në mënyrë që mund të jetë abuzive ose që mund t'i vendosë të tjerët në rrezik abuzimi.
- Mos rri vetëm me një fëmijë në asnjë rrethanë që mund të iu kërkohet nga të tjerët.
- Mos lejoni që fëmijët të angazhohen në lojëra seksuale provokuese me njëri-tjetrin.
- Mos puthni, përqafo, ledhatoni, fërkoni ose prekni një fëmijë në një mënyrë të papërshtatshme ose në mënyrë kulturore të papranueshme (p.sh. mos filloni kontakt fizik, siç është mbajtja e duarve, përveç nëse kjo inicohet nga fëmija).
- Të mos jeni në ndikim të alkoholit apo substancave të tjera gjatë kohës kur punoni me fëmijë.
- Mos sugjeroni dhe mos inkurajoni sjellje apo marrëdhënie të papërshtatshme të çfarëdo lloji.
- Mos merrni fotografi, filmime ose kërkoni informacione personale nëse kjo nuk kërkohet për aktivitetet e organizatës.
- Mos i përdorni në mënyrë jo të duhur detajet e kontakteve të fëmijëve.
- Mos lejoni shkeljen e këtij kodi nga të tjerët - stafi, praktikantët, konsulentët etj.
- Asnjëherë mos mbyllni sytë, injoroni ose mos të raportoni ndonjë shqetësim, shkelje të dyshuar ose shkelje të drejtave të fëmijës që bie ndesh me Kodin e Sjelljes apo me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës.

REAGIMI DHE MBROJTJA

5. PROCEDURAT E RAPORTIMIT

I gjithë personeli, menaxhmenti, vullnetarët dhe praktikantët duhet të jenë të vëmendshëm ndaj shenjave që mund të sugjerojnë se një fëmijë ka nevojë për ndihmë (shih shtojcën 1). Vendimi nëse duhet të raportohet mund të jetë një përgjegjësi shumë e vështirë. Procedura e raportimit është bërë gjerësisht e disponueshme për të siguruar që të gjithë janë të qartë se çfarë hapash duhen ndërmarrë në lidhje me sigurinë e fëmijëve dhe dëshmitarëve të tjerë.

Të gjitha dëshmitë, dyshimet ose shkeljet e pohuara apo të dyshuara të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës të organizatës duhet raportohen menjëherë tek personi pikë kontakti përgjegjës i mbrojtjes së fëmijës duke përdorur formularin e raportimit (shtojca 2). **Parimi udhëheqës** duhet të jetë se siguria e fëmijës është gjithmonë konsiderata më e rëndësishme. Këto të dhëna do të ruhen në mënyrë të sigurtë me qasje të kufizuar tek personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës ose tek menaxhmenti apo bordi (varësisht sipas hierarkisë dhe strukturës organizative të organizatës).

Në takimet dhe aktivitetet ku fëmijët janë të përfshirë drejtpërsëdrejti, fëmijët do të informohen për politikën e organizatës, kodin e sjelljes, ekzistencën e personit përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës dhe mekanizmin e ankesave në një mënyrë miqësore për fëmijët.

Faza e parë është të vendoset nëse shqetësimet janë të brendshme të organizatës apo lidhen me një situatë të jashtme.

Kur një shqetësim për mbrojtjen e fëmijës është sjellë në vëmendjen tuaj – VEPRO.

VEPRO për shqetësimin tuaj / Nëse keni dyshime, flisni hapur.

Vendoseni fëmijën në qendër. Mbrojtja e fëmijës është konsiderata parësore.

Koha llogaritet. Siguro veprimet efektive në kohë, të duhura dhe konfidenciale lidhur me mbrojtjen e fëmijës⁷.

Nëse shqetësimi është i brendshëm - në lidhje me sjelljen e personelit, menaxhmentit, vullnetarëve, praktikantëve, anëtarit ose anëtarëve të bordit, duhet ta shqyrtoni nëse duhet të raportoni tek autoritetet lokale / nacionale. Nëse jo, ju duhet të zbatoni procedurat e brendshme të mbrojtjes. Nëse po, ju duhet të raportoni tek autoritetet e përcaktuara dhe të përcillni veprimet e ndërmarra nga autoritetet dhe të vendosni për përgjigje të mëtejshme, ta regjistroni rastin dhe veprimet e ndërmarra.

Nëse shqetësimi është i jashtëm - do të thotë se ka shqetësime sa i përket abuzimit jashtë organizatës. Ju duhet ta raportoni tek autoritetet vendore ose nacionale. Pas kësaj zbatohet e njëjta procedurë si për shqetësimet e brendshme.

Personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës do të veprojë në lidhje me shqetësimet, pohimet ose pretendimet në mënyrë konfidenciale në përputhje me procesin e standardizuar të zhvilluar nga organizata në interesin më të mirë të fëmijës, pavarësisht nga natyra e referimit, akuzat ose kush është referuesi apo i akuzuari. Personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës do të ndërmarrë veprimet e duhura për të mbrojtur fëmijën/fëmijët në fjalë nga dëmtimet e mëtejshme gjatë dhe pas një incidenti ose pretendimi. Do të ofrohet menjëherë një vlerësim i llojit specifik të mbështetjes dhe ndihmës që nevojitet nga fëmija i prekur nga incidenti. Të dhënat përkatëse të kontakteve për shërbimet sociale, policinë, ndihmën e shpejtë, emergjencën, duhet të jenë lehtësisht të disponueshme dhe lehtësisht të arritshme (shih shtojcën 4 me kontaktet kryesore). Personi përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës do të jetë përgjegjës për të kontaktuar familjen (ose kujdestarin) e fëmijës dhe për t'i informuar ata për incidentin dhe ndihmën e ofruar. Një raport (shtojca 2) duhet të përpilohet për të dokumentuar detajet e incidentit. "Interesi më i mirë i fëmijës" duhet të konsiderohet gjatë tërë procesit.

⁷Burimi: Plani Ndërkombëtar, Raportimi i Politikave të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Reagimi ndaj Çështjeve të Mbrojtjes së Fëmijëve në Plan

5.1 Procedura e brendshme e mbrojtjes

Organizata do të pezullojë menjëherë çdo punonjës, vullnetar, praktikant, anëtar të bordit, konsulent, këshilltar i cili supozohet se ka shkelur Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës, derisa është në pritje të rezultateve të hetimit.

Organizata rezervon të drejtën për të ndërmarrë veprime disiplinore kundër ndonjë prej të lartpërmendurve për të cilët është vlerësuar se kanë shkelur Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës, dhe kjo mund të rezultojë edhe me raportimin e incidentit/rastit në polici.

Veprat e natyrës penale duhet të raportohen menjëherë në polici dhe ato mund të rezultojnë me hetim dhe dënime.

Raporti i vlerësimit të brendshëm nga organizata do t'i dorëzohet menaxhmentit, anëtarëve të bordit (varësisht nga struktura dhe hierarkia e organizatës) të cilët do të marrin vendim për veprimet që duhen ndërmarrë. Vendimet do të kumtohen me shkrim personit në fjalë.

Kur shqyrtoni shqetësimet ose pretendimet, për shkeljen e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës, procesi duhet të jetë gjithmonë i drejtë dhe individit duhet të ketë të drejtën e ankesës për vendimin. Ankesa duhet të shqyrtohet nga një organ më i lartë në kuadër të hierarkisë së organizatës.

MEDIA DHE KOMUNIKIMI

6. UDHËZIME PËR MEDIA DHE KOMUNIKIMIN

Ky kapitull i Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës përcakton parimet që organizata ndjek për komunikim të jashtëm. Kapitulli përmban parime të përgjithshme për të siguruar që fëmijët mbahen të sigurtë në çdo kohë, si dhe udhëzime specifike të cilat duhet të zbatohen nga stafi i organizatës si dhe fotografët, ekipet e produksioneve filmike dhe gazetarët të cilët përcjellin apo vizitojnë ngjarjet dhe aktivitetet e organizatës.

Të gjitha masat për mbrojtjen e fëmijëve në Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës janë njësoj të zbatueshme sikurse në aktivitetet e mediave dhe komunikimit, poashtu në përdorimin e rrjeteve sociale.

Për të siguruar që të gjithë fëmijët janë të mbrojtur në të gjitha situatat është e rëndësishme të keni pëlqimin me shkrim të prindit/kujdestarit të fëmijëve që tregon qartë nëse ata pranojnë që fotografitë apo deklaratat e fëmijëve mund të përdoren publikisht apo jo. *(Shtojca 3 përfshin një formular specifik të miratimit për përdorim mediatik).*

6.1 Parimet

Të drejtat dhe dinjiteti i fëmijës duhet të respektohen në çdo kohë dhe fokusi jonë i komunikimit qëndron në respektimin e interesit më të mirë të fëmijës. Intitucioni/organizata asnjëherë nuk duhet të përdorë gjuhë diskriminuese ose degraduese. Ky seksion jep udhëzime për përdorimin e imazheve, filmimeve dhe tregimeve të fëmijëve për qëllime mediatike dhe të komunikimit për të siguruar mbrojtjen e të dhënave dhe për të mbrojtur vetë fëmijët. Abuzuesit ndonjëherë kanë synuar figurat e fëmijëve të cilëve kanë parë në media apo në materiale të komunikimit.

Në komunikimet e organizatës rreth fëmijëve, do të zbatohen parimet e mëposhtme:

Dinjiteti: Dinjiteti i fëmijës duhet të ruhet në çdo kohë. Gjuha e përdorur nuk duhet të degradojë, viktimizojë ose turpërojë fëmijën. Në imazhe, fëmijët duhet të jenë gjithmonë të veshur në mënyrë të përshtatshme dhe kurrë nuk duhet të paraqiten në ndonjë pamje që mund të interpretohet si seksualisht provokative. Mos bëni dhe mos publikoni fotografi të fëmijëve që janë krejtësisht të zhveshur ose të veshur në mënyrë jo të përshtatshme. Mos i paraqisni fëmijët si viktimë (të dobët, të dëshpëruar etj). Imazhet duhet të paraqesin forcën, shpresën tek fëmijët dhe ti paraqesin ata në një mënyrë 'pozitive'.

Saktësia: Portretizimi i fëmijëve nuk duhet të manipulohet në asnjë mënyrë. Imazhet dhe tregimet duhet të sigurojnë një përshkrim të ekuilibruar të jetës dhe rrethanave të fëmijës, duke treguar progresin që fëmijët po bëjnë. Komunikimet duhet të shmangin bërjen e përgjithësimeve, të cilat nuk pasqyrojnë saktësisht natyrën e situatës dhe pamjet nuk duhet të merren dhe të përdoren jashtë kontekstit.

Privatësia: Çdo informacion që mund të përdoret për të identifikuar një fëmijë ose për t'i vënë ato në rrezik, nuk do të përdoret. Organizata duhet të sigurojë që:

- Përdor vetëm emrat e fëmijës (pa mbiemër): sigurohuni që të mos tregoni hollësi për vendin ku ata jetojnë, shkollën e tyre dhe informacione të tjera që do të çonin në vendin e tyre të banimit. Nëse mbrojtja e identitetit të fëmijës është e nevojshme, edhe emrat dhe imazhet e tyre duhet gjithsesi të ndryshohen/mbulohen.
- Informacioni për fëmijën/fëmijët dhe fotografitë e fëmijëve (përfshirë informacionin e ruajtur në kompjuter) do të mbahen në dosje të sigurt. Qasja në dosje duhet të kufizohet vetëm tek ata/ato që duhet t'i përdorin gjatë punës së përditshme.
- Imazhet e regjistruara duhet të fokusohen në aktivitet dhe, kur është e mundur, të shfaqin grupe të fëmijëve në vend të vetëm një fëmije.

- Organizata angazhohet të përfaqësojë në publikimet e saj (video-t) një gamë të gjerë të fëmijëve - djem dhe vajza, të moshave të ndryshme, aftësive të ndryshme dhe grupeve etnike. Organizata do të sigurojë diversitetin e fëmijëve që do të paraqiten në materialin e saj të komunikimit.

Procedura e ankesave: Çdo ankesë ose shqetësim rreth imazheve të papërshtatshme ose ndërhyrëse duhet të raportohet dhe regjistrohet sikurse çdo shqetësim tjetër rreth mbrojtjes së fëmijëve (*shih kapitullin 6*).

6.2 Pëlqimi paraprak

Pëlqimi paraprak duhet gjithmonë të kërkohet para se të merret ndonjë fotografi, video ose të kërkohen informacione personale për jetën e fëmijëve që mund të përdoren më pas në materialet e organizatës. Pëlqimi paraprak nënkupton që fëmijëve u është thënë se si organizata mund të përdorë informacionin ose imazhin/filmimin. Fëmijët janë të lirë të mos pranojnë publikimin e imazheve, filmimeve dhe materialeve rreth tyre. Ata gjithashtu duhet të sigurohen që lokacioni dhe informacione të tjera të fëmijës do të ndryshohen. Ata do të duhet të pyeten nëse dëshirojnë të japin pëlqimin që emri i tyre të përdoret me informacionin ose imazhin/filmin.

Pëlqimi duhet të merret duke plotësuar dhe nënshkruar formularin e pëlqimit për përdorim mediatik (*të përfshira në format e pëlqimit në shtojcën 3*).

Pëlqimi kërkohet gjithashtu nga prindi ose kujdestari ligjor i fëmijës, i cili duhet të nënshkruajë formularin. Në rast se kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të kërkohet nga organizata e cila punon me fëmijët. Organizatat që punojnë me fëmijët duhet të udhëheqin procesin e kërkimit të pëlqimit të fëmijëve dhe të prindërve, pasi ata mund të ndihen më rahat për të pranuar pëlqimin kur kërkohet nga dikush që ata tashmë i njohin dhe besojnë.

Format e pëlqimit për media dhe format e tjera të pëlqimit do të mbahen në organizatë, në dosjen e fëmijës.

Marrja e pëlqimit paraprak me shkrim, nuk e përjashton edhe marrjen e pëlqimit verbal në kohën e marrjes së fotografive/videove/intervistave.

6.3 Intervistimi i fëmijëve

Intervistimi i fëmijëve kërkon aftësi dhe disa parime themelore të cilat duhet të ndiqen për të siguruar se janë duke u respektuar dinjiteti dhe të drejtat e fëmijëve.

- **Pëlqimi i informuar:** Në lidhje me intervistat, pëlqimi i informuar përfshin shpjegimin se cilat tema mund të diskutohen në intervistë dhe qartësojnë të drejtën e fëmijës për të tërhequr pëlqimin e tij/saj në çdo moment. Intervistuesi duhet të shqyrtojë nëse fëmija e ka kuptuar formën e pëlqimit në fillim të intervistës.
- **Sigurimi i mbështetjes:** Gjatë intervistës duhet të jetë i pranishëm ndonjë person me të cilin fëmija është i njohur. Fëmijës duhet ti jepet mundësia të zgjedh se kush do ta mbështes atë gjatë intervistës.
- **Respektimi i së drejtës për të thënë Jo:** Para se të filloni intervistën jeni të qartë që fëmija duhet të flasë vetëm nëse ndihet komod duke i shpjeguar fëmijës që ai/ajo mund të ndalojë dhe të tërheq pëlqimin në çdo moment.
- **Gjinia:** Konsideroni nevojat e ndryshme të djemve dhe vajzave dhe nëse do të ndiheshin më komod për të folur me një burrë apo një grua. Gjinia duhet të merret në konsideratë kur të vendoset se cilat tema mund të diskutohen.
- **Respektimi i së drejtës për tu informuar:** Nëse do të mbani shënime ose regjistroni intervistën në një mënyrë apo tjetër, ju duhet t'ia shpjegoni këtë fëmijës dhe të kërkoni lejen e tij për ta bërë këtë.

6.4 Vizitat nga fotografët, produksionet filmike, gazetarët dhe të tjerët

Kujdes i veçantë duhet të merret kur organizohen vizita për fotografë të jashtëm, ekipet e xhirimeve, gazetarët apo vizitorët brenda fushës së projekteve, aktiviteteve dhe publikimeve të organizatës:

- Gazetarët, fotografët/ekipet filmike duhet të jenë plotësisht të informuar për politikën e mbrojtjes së fëmijës të organizatës para se të takohen me fëmijët, të cilët do të intervistohen, fotografohen ose filmohen. Ata duhet të nënshkruajnë angazhimin e tyre për t'iu përmbajtur kësaj politike.
- Sigurohuni që fotografëve dhe prodhuesve të filmave nuk u lejohet të kalojnë kohë ose të kenë qasje tek fëmijët pa mbikëqyrje. Ata duhet të shoqërohen nga stafi i organizatës në çdo kohë.
- Fëmijët, prindërit dhe kujdestarët duhet të informohen për mënyrën se si do të përdoret filmimi, fotografia ose tregimi dhe duhet të merret pëlqimi për këtë. Kjo dallon nga pëlqimi që ata kanë dhënë për përdorimin e materialeve nga organizata në të cilën ata janë të përfshirë.
- Kopjet e imazheve, filmimeve dhe tregimeve duhet t'ju dërgohen prindërve, kujdestarëve dhe fëmijëve.
- Për të mbrojtur konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijëve, organizata duhet të informohet se si fotografi, gazetari apo ekipet e xhirimit kanë ndërmend të përdorin imazhet apo tregimet e fëmijëve.

Organizata rezervon të drejtën e refuzimit të lejimit të përdorimit të fotografive, tregimeve, filmimeve, nëse vlerëson se, duke bërë kështu organizata nuk është duke vepruar në përputhje me politikën e mbrojtjes së fëmijëve dhe parimet e organizatës lidhur me mediat dhe komunikimin.

- Nëse një imazh ose material i organizatës kërkohet të përdoret nga një organizatë tjetër, duhet të merret e drejta për ta përdorur, duke shënuar të drejtën e autorit të organizatës © në fjale si dhe emrin e fotografit me një titull të përshtatshëm.

MONITORIMI DHE LLOGARIDHËNIA

7. LLOGARIDHËNIA: MONITORIMI DHE VLERËSIMI I POLITIKËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës është të mësojë nga përvojat praktike të rasteve, të cilat do të kontribuojnë në rishikimin e politikave dhe ndryshimeve në Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës.

Organizata do të monitorojë rregullisht zbatimin e procedurave dhe zbatimin e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës. Progresi, performanca dhe mësimet e nxjerra raportohen çdo vit nga personi kontaktues i mbrojtjes së fëmijëve tek menaxhmenti apo bordi (varësisht se si është e përcaktuar në organizatë), dhe përfshihen në raportet vjetore të organizatës. Monitorimi dhe vlerësimi do të bëhet duke kontrolluar nëse standardet e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës janë duke u zbatuar dhe nëse masat mbrojtëse janë duke funksionuar. Kjo do të bëhet duke kryer një sondazh në mes të stafit të organizatës, praktikantëve dhe vullnetarëve mbi mënyrën se si përmbushen

standardet nga Politika e Mbrojtjes së Fëmijës, sa janë efektive dhe cilat janë nevojat për përmirësim.

Krahas monitorimit dhe vlerësimit të përgjithshëm të Politikës të Mbrojtjes së Fëmijës, monitorimi reaktiv do të zhvillohet pas incidenteve, të cilat do të kontribuojnë në një proces të të mësuarit për organizatën dhe nëse nevojitet ndryshime në Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës ose procedurat e raportimit.

Çdo tre vjet duhet të kryhet një rishikim i brendshëm i politikës dhe rezultatet e tij do të miratohen nga organi më i lartë menaxhues apo drejtues. Përveç kësaj, rekomandohet që një vlerësues i jashtëm të shqyrtojë politikën dhe praktikën. Kjo mund të bëhet përmes çertifikimit të "Keeping Children Safe". Organizata duhet të synojë të marrë çertifikatën "Keeping Children Safe".

8. DEKLARATA E ZOTIMIT E ORGANIZATËS PËR POLITIKËN E MBROJTJES SË FËMIJËS

Unë, _____, kam lexuar dhe kuptuar standardet dhe udhëzimet e përshkuara në këtë Politikë të Mbrojtjes së Fëmijës. Unë pajtohem me parimet, përmbajtjen dhe pranoj rëndësinë e zbatimit dhe promovimit të politikave, procedurave dhe praktikave të mbrojtjes së fëmijëve të përfshira në këtë dokument gjatë punës sime me organizatën.

Unë e kuptoj më tej se respektimi i Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës të organizatës do të përfshijë: ti nënshtrohem një kontrolli për dënimet penale që lidhen me punën me fëmijët, nënshkrimit të një deklaratë personale që thekson çdo dënim penal, duke përfshirë ato që konsiderohen “të shkuara”, deklarimi i ndonjë hetimi të mëparshëm ose pretendimi të bërë kundër meje në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, dhe sigurimin e dy referencave rreth karakterit.

_____ (Emri)

_____ (Pozita)

_____ (Nënshkrimi)

_____ (Data)

9. REFERENCA RRETH KARAKTERIT

Ju lutem të shkruani emrin, adresën dhe kontaktet e dy referencave që njihni për jo më pak se dy vjet, duke përfshirë anëtarët me lidhje familjare:

Emri:	Emri:
Adresa:	Adresa:
Numri kontaktues:	Numri kontaktues:
E-mail:	E-mail:

Deklarimi i dënimeve penale

A keni qenë ndonjëherë i/e dënuar për ndonjë krim? **Po** ____ **Jo** ____

Nëse po, ju lutemi jepni detajet e të gjitha dënimeve penale, përfshirë ato që konsiderohen të 'shkuara' dhe deklaroni ndonjë hetim të mëparshëm ose kallzim penal të bërë kundër jush. Këto do të mbahen konfidenciale nga personi kontaktues i caktuar për mbrojtje të fëmijës në organizatë, i cili do të vlerësojë nëse ato përbëjnë ndonjë rrezik apo nuk janë në përputhje me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës të organizatës.

SHTOJCAT

Shtojca 1: Njohja e shenjave të abuzimit

Njohja e shenjave të abuzimit të mundshëm është mjaft komplekse dhe nuk ka ndonjë metodë të thjeshtë, e cila mundëson njohjen e shenjave në mënyrë të lehtë. Ka shenja paralajmëruese potenciale që duhet të jeni të vëmendshëm, por duhet të vlerësohen me shumë kujdes. Nuk duhet të supozohet automatikisht se abuzimi po ndodh. Poashtu, është e rëndësishme të mos i hedhësh poshtë shqetësimet tuaja ose të mos shpërfillësh ndonjë shenjë abuzimi - këto duhet të diskutohen me personin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës, sa më shpejtë që të jetë e mundur për të ndihmuar në përcaktimin veprimeve më të përshtatshme.

Shenjat e mundshme të abuzimit fizik:

- Mavijosje, plagë, ndrydhje, thyerje apo kafshime
- Justifikime të pa qëndrueshme, që ipen për të shpjeguar lëndimin
- Refuzim për të diskutuar rreth lëndimeve
- Shmangie e kontakteve fizike
- Mbulimi i këmbëve dhe krahëve edhe në kohë të nxehta
- Mosgatishmëria për të marrë pjesë në aktivitete fizike që mund të përfshijnë zhveshjen e rrobave p.sh aktivitetet sportive
- Frika për tu kthyer në shtëpi apo kontaktuar me prindërit
- Tendenca për shqetësim
- Shfaq kujdes apo mosbesim tek të rriturit
- Të qenurit agresiv ndaj të tjerëve
- Të qenurit shumë pasiv dhe i urtë
- Vrapime të shpejta e të pa kontrolluara

Shenjat e mundshme të abuzimit emocional:

- Zhvillim fizik, njohës apo emocional të vonuar
- Shumë i/e shqetësuar
- Shfaqja e vonësive apo çrregullimeve në të folur
- Lag apo ndytytë shtratin
- Frika ndaj situatave të reja
- Mungesë të vetëbesimit
- Përgjigjje emocionale të papërshtatshme ndaj situatave
- Pasivitet ekstrem apo agresivitet
- Përdorimi i drogave apo alkoolit
- Vrapime të shpeshta e të pakontrolluara
- Vjedhje të vazhdueshme

Shenjat e mundshme të neglizhimit:

- Uri të shpeshtë
- Marrja e mbetjeve të ushqimit nga pjata, apo vjedhje të ushqimit
- Higjenë të papastër personale
- Lodhje e vazhdueshme
- Veshje të papërshtatshme, p.sh rroba të verës në dimër
- Mungesa të shumta në shkollë, apo braktisje të shkollës
- Probleme mjekësore të patrajtuara
- Marrdhënie të dobëta sociale me të tjerët
- Vjedhje
- Mungesë vetëbesimi
- Përdorimi i drogave dhe alkoolit

Shenjat e mundshme të abuzimit seksual:

- Sjellje të papërshtatshme seksuale, ose përdorim i tepërt i fjalëve seksuale
- Dhimbje anale apo gjenitale
- Probleme me gjumë
- Lagje apo ndotja e shtratit
- Frika për të qëndruar me të rritur
- Marrja e rreziqeve të larta në adoleshencë

Shenja të mundshme lidhur me sjelljen e të rriturve:

- Një person, në prezencën e të cilit, sjellja e një fëmije ndryshon në mënyrë të konsiderueshme, sikurse të bërit i tërhequr, i frikësuar, apo shqetësuar.
- Kërkimi nga një fëmijë që të gënjejë ose të mbajë sekrete.
- Shkelja e kodit të mirësjelljes apo protokolleve të sjelljes së organizatës.
- Inicimi i kontakteve private me fëmijë, personalisht, përmes telefonit apo përmes e-mail.

Shtojca 2: Forma raportuese e mbrojtjes

Nëse keni njohuri se një fëmijë mund të jetë në rrezik, ju lutemi të plotësoni këtë formular sa më shumë që keni njohuri për rastin në fjalë. Ju lutem vini re se shqetësimet për mbrojtjen e fëmijëve duhet të raportohen (*me gojë ose me shkrim*) direkt tek personi përgjegjës i mbrojtjes së fëmijës në organizatë (mundësisht brenda ditës së njejtë të punës) - në varësi të urgjencës, ju mund të plotësoni këtë formular para se të kontaktoni me të, apo mund të e plotësoni më pas.

Gjithashtu përdorni këtë formular për të raportuar një aksident ose incident. Një aksident është një ngjarje e paplanifikuar e cila rezulton me një dëmtim ose mund të ketë rezultuar me një dëmtim të pajisjeve, pronës ose dëmtim të mjedisit. Një incident është një ngjarje e pakëndshme dhe e pazakontë.

Raporti duhet të shkruhet dhe të nënshkruhet vetëm nga ju për të garantuar konfidencialitetin. Duhet të dërgohet vetëm tek personi përgjegjës i mbrojtjes së fëmijës, i cili do ta mbajë atë në një vend të sigurt dhe do ta trajtojë atë me konfidencialitetin më të mirë të mundshëm.

1. Rreth jush

Emri: _____

Pozita: _____

Organizata për të cilën punoni: _____

Natyra e kontaktit tuaj me fëmijën: _____

Kontakti: Tel: _____

E-mail: _____

2. Rreth fëmijës

Emri i fëmijës: _____

Gjinia e fëmijës: _____

Mosha e fëmijës: _____

Adresa e fëmijës: _____

Prindi/kujdestari i fëmijës: _____

A i është dhënë ndonjë trajtim fëmijës?

Trajtimi i dhënë nga: _____

Është dërguar në spital PO _____ ; JO _____ ;

Nëse po, në cilin spital është dërguar, dhe si:

10. Rreth shqetësimit/çështjes tuaj; Detajet e incidentit

Incidenti ishte:

Vëzhguar nga ju

Dyshuar

Dyshuar nga dikush tjetër

Nëse rreth incidentit jeni njoftuar përmes dikujt tjetër, ju lutem të tregoni nga kush dhe relacionin e tij/saj me fëmion.

Çfarë ka ndodhur? Tregoni shkakun (si dhe pse) nëse e dini – Nëse do të përfshini vërtetim personal ju lutem të bëni dallimin në mes të asaj se çfarë është e vërtetë (faktet) dhe çfarë është mendim apo thashëthëme (p.sh. gjendja emocionale e fëmijës, dëmtimet e dukshme, etj.):

Modeli i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës

A keni ndonjë informatë nga fëmija apo ndonjë burim tjetër që ju ka thënë diçka [nëse i përshtatshëm] dhe si jeni përgjigjur te ai/ajo:[Mos e udhëheqni/drejtoni fëmijën në përgjigje. Regjistro detajet aktuale]

Data e incidentit të pretenduar: _____

Koha e incidentit të pretenduar: _____

Vendi i incidentit të pretenduar: _____

Emri i kryerësit të supozuar (nëse është e aplikueshme): _____

A kishte ndonjë fëmijë/person tjetër të përfshirë në incidentin e supozuar?

A ka ndonjë fëmijë tjetër në rrezik? _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Për plotësim nga personi kontaktues i mbrojtjes së fëmijës:

Incidenti/Aksidenti u vlerësua: Po Jo

Raporti me shkrim i vlerësimit: Po Jo

Raport i shkruar i vlerësimit i nevojshëm: Po Jo

Për të përcaktuar shkakun e incidentit ose aksidentit, mund të jetë e përshtatshme për të intervistuar palët që janë të përfshira. Detajet për dëshmitarin, deklaratat, etj mund të shtohet këtu.

Shtojca 3 Format e pëlqimit

TË DHËNAT PERSONALE DHE TË DHËNAT NË RAST EMERGJENCE

Emri dhe mosha:	
Adresa:	
Numri i telefonit:	
Numri mobil i telefonit (nëse është në dispozicion):	
E-mail adresa:	

A jeni i/e lumtur të merrni pjesë (p.sh takim/ngjarje, etj)?

Ju lutem të shënoni Po ose Jo:

Po

Jo

NE DUAM TË SIGUROHEMI QË JU NDIHENI TË MIRËSEARDHUR DHE TË MERRNI PJESË REHAT

A keni ndonjë alergji që ne duhet ta dimë?

- Po
 Jo

Detajet: _____

A keni ndonjë nevojë shtesë për mbështetje të cilën do të doni të na njoftoni (aftësi të kufizuar fizike apo vështirësi në të mësuar, probleme të shëndetit mendor, mungesë vetëbesimi, vështirësi në komunikim, gjëra për të cilat ju vie vështirë të flisni)?

- Po
 Jo

Detajet: _____

A ka diçka që ne mund të bëjmë më shumë, për të ju siguruar se ju mund të vini, të sigurojmë pjesëmarrjen tuaj të plotë?

- Po
 Jo

Detajet: _____

A jeni duke përdorur ndonjë terapi/barna për të cilat duhet të dijmë?

- Po
 Jo

Detajet: _____

A keni ndonjë kërkesë sa i përket ushqimit?

- Po
 Jo

Detajet: _____

Nëse praktikoni një fe, ju lutemi na tregoni nëse ka ndonjë gjë që lidhet me pjesëmarrjen në ngjarje për të cilën duhet të dimë?

Detajet: _____

NË RAST TË EMERGJENCËS

Personi kontaktues në raste EMERGJENTE. Është shumë e rëndësishme që ju ta plotësimi këtë formë plotësisht.

Emri 1:	Emri 2:
Marrëdhënia me ju:	Marrëdhënia me ju:
Numri i telefonit:	Numri i telefonit:
Mobil:	Mobil:
Në rast emergjence, a pajtoheni se pranoni të merrni trajtim spitalor ose dentar, duke përfshirë ndonjë ndërhyrje ndërhyrje me anestezië?	Detajet:
Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	

<p>Pëlqimi im:</p> <p>Nënshkrimi:</p> <p>Vendi (ku jetoni):</p> <p>Data sot:</p>	<p>Pëlqimi i prindit/kujdestarit (nëse fëmija është nën 18 vjeç)</p> <p>Fëmijës/personit nën 18 vjeç:</p> <ul style="list-style-type: none"> • I lejohet të marrë pjesë në(ngjarje). • I lejohet të marrë pjesë në aktivitete media-tike..... (ngjarje). • Ka qenë i informuar rreth (ngjarjes) qëllimin, natyrën vullnetare të pjesëmarrjes. • Ka qenë i/e informuar se mund të refuzojë të mos marrë pjesë, në çdo kohë, pa ndonjë pasojë. • I lejohet të marrë trajtim të duhur mjekësor nga praktikues të regjistruar/licensuar në rast se fëmija ka nevojë emergjente për trajtim mjekësor. <p>Emri i plotë i prindit/kujdestarit:</p> <p>Marrëdhënia me fëmijën:</p> <p>Lokacioni:</p> <p>Data:</p>
---	---

FORMA PËR PËRDORIM MEDIATIK

NE DUAM QË JU TË NDIHENI REHAT TË MERRNI PJESË NË AKTIVITETE MEDIATIKE

Organizata dhe Ekipi i Komunikimit duhet të promovojnë në mënyrë aktive (p.sh aktivitetet/ngjarjet/etj.). **Ne publikojmë fotografi dhe qëndrime të pjesëmarrësve.** Në këtë mënyrë ne informojmë publikun dhe vendimarrësit rreth.....(ngjarjes).

Nëse ju apo prindërit/kujderstari jeni të interesuar për të na ndjekur në rrjetet tona sociale, këtë mund të e bëni duke na ndjekur në faqen tonë zyrtare në Facebook dhe në Webfaqe:

- A është në rregull për ju që të merrni pjesë në dokumentimin vizual gjatë ngjarjes së organizatës..... (ngjarjes)? Nëse thoni se është në rregull, ne mund të publikojmë fotografitë, filmimet, audiot, apo ndonjë shkrim në faqen tonë të internetit ose në mediat sociale; në raportet tona ose fletëpalosjet; në ngjarjet tona, për të promovuar të drejtat e fëmijëve dhe mbështetur fëmijët.

Ju lutem të përgjigjeni me Po ose Jo:

- Po
 Jo

- A është në rregull për ju nëse ne kapim zërin tuaj në filmime, fotografi, audio, shkrim dhe ta publikojmë këtë përmbajtje në format e renditura si më lart?

Ju lutem të përgjigjeni me Po ose Jo:

- Po
 Jo

- A është në rregull për ju nëse ne u tregojmë njerëzve emrin tuaj të parë kur e publikojmë këtë përmbajtje? (akoma mund të marrësh pjesë në (ngjarje) edhe nëse nuk dëshiron që ne t'ju themi të tjerëve emrin tënd).

Ju lutem të përgjigjeni me Po ose Jo:

- Po, ju mund ta publikoni emrin tim
 Jo, ju nuk mund ta publikoni emrin tim

Modeli i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës

- A është në rregull për ju që të flisni me shtypin/mediat gjatë (ngjarjes) (duke përfshirë fotografitë, mbulimin mediatik (televiziv/video/kamera)? Të gjitha intervistat e medias do të bëhen në konsultim me dhe në prani të të rriturve tuaj shoqërues dhe një anëtar të stafit të organizatës. Ju keni të drejtë të mos i përgjigjeni Medias ndonjë pyetjeje që nuk dëshironi t'i përgjigjeni.

Ju lutem të përgjigjeni me Po ose Jo:

- Po
 Jo

INFORMATAT PËR KONTAKTET KYÇE

KONTAKTET E BRENSHME

Personi përgjegjës kontaktues për Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve
Emri dhe mbiemri:
Adresa:
Tel:
E-mail:
Menaxhmenti
Emri dhe mbiemri:
Adresa:
Tel:
E-mail:
Bordi
Emri dhe mbiemri:
Adresa:
Tel:
E-mail:

KONTAKTET JASHTË ORGANIZATËS

Policia e Kosovës
Adresa:
Tel:
E-mail:
Qendra për Punë Sociale (sipas komunës)
Adresa:
Tel:
E-mail:
Mbrojtësit e Viktimave
Adresa:
Tel:
E-mail:
Ndihma e shpejtë
Adresa:
Tel:
E-mail:

Shënim: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 254, përcakton obligimin ligjor për raportim, si dhe pasojat dhe denimet në rast të dështimit për raportim të rasteve të abuzimit.

Neni 254

Mos raportimi i abuzimit të fëmijëve

1. Pavarësisht nga dispozitat tjera ligjore, kushdo që ka arsye për të dyshuar se një fëmijë ka pësuar një incident të abuzimit të fëmijës, keqtrajtimit, braktisjes apo moskujdesit dhe nuk raporton menjëherë abuzimin ose moskujdesin, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues apo kujdestari, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që gjatë angazhimit profesional lidhur me fëmijën, ka arsye për të dyshuar se fëmija ka pësuar incident të abuzimit të fëmijës, keqtrajtimit, braktisjes apo moskujdesit ose ka qenë i nënshtruar ndaj dhunës apo kanosjes për përdorim të dhunës, dhe nuk e raporton menjëherë rastin, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e fëmijës apo me dëmtim të rëndë të shëndetit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Publikuar nga:

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF
Zenel Salihu, OB.1 HY.1 K.3No.16,
10000 Prishtinë,
Kosovë 2017
+ 381 38 220 287
www.komfkosova.org